



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 977, datë 2.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN
E PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT,
NË BASHKITË KAVAJË DHE KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 115 377 718 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në bashkitë Kavajë dhe Krujë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.

- b) Bashkisë Krujë i transferohet fondi prej 72 377 718 (shtatëdhjetë e dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kavajë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE


MINISTRI I SHITETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6087/1
DATË 3.12. 2020

MINISTRIT TË SHITETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAVAJË DHE KRUIJË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI



A circular official stamp in blue ink is positioned behind the signature. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHqipërisë' at the top, 'MINISTRITË E FINANCEVE DHE EKONOMISË' on the right, and 'KESHILLI I MINISTREVE' at the bottom. The signature 'Engjell Agaci' is written in black ink over the stamp.